



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 81/4 Prot

Tiranë, më 11.06.2021

V E N D I M

Nr.71, datë 11.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së konkurrimit për ngritje në detyrë (Aplikim nr. 109), për pozicionin “Përgjegjës - Sektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor”, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit” dhe konkurrimeve për lëvizje paralele, (Aplikimi nr. 111), pozicioni, “Përgjegjës – Zyra Rajonale Statistikore Korçë, Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit”; (Aplikimi nr.112), pozicioni, “Specialist – Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Mjedisit”, në Institutin e Statistikave .

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërejt se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 81 prot., datë 18.01.2021, nëpunësi *****, aktualisht specialist në Zyrën Rajonale Statistikore Tiranë, të Institutit të Statistikave, ka ngritur pretendime për parregullsi në procesin e vlerësimit, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për ngritje në detyrë dhe lëvizje paralele, të zhvilluara në këtë institucion në të cilat ai ka marrë pjesë, si dhe për një ulje të padrejtë të pagës në shumën 10.000 lekësh, pa asnjë spjegim nga drejtuesit e institucionit.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, u shqyrtua gjithë dokumentacioni shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera në realizimin e procedurave të

konkurrimit dhe qëndrimin e mbajtur nga institucioni për uljen e pagës, nga analiza e të cilit rezultoi sa më poshtë:

Nëpunësi civil *****, duke qenë i punësuar në pozicionin “*Specialist në Zyrën Rajonale Statistike Tiranë*”, të Institutit të Statistikave, ka marrë pjesë në procedurën konkurruese, për ngritje në detyrë *Aplikimi nr. 109*, pozicioni, “*Përgjegjës - Sektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, Instituti i Statistikave – Kategoria: III-a*”; si dhe në procedurat e konkurrimit për lëvizje paralele: *Aplikimi nr. 111*, pozicioni, “*Përgjegjës – Zyra Rajonale Statistike Korçë, Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave, Instituti i Statistikave – Kategoria: III-b*” dhe *Aplikimi nr. 112*, pozicioni, “*Specialist – Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, Instituti i Statistikave – Kategoria: III-b*”, në Institutin e Statistikave.

Në përfundim të fazës së dytë të konkurrimit, pas kryerjes së vlerësimit, nëpërmjet email-it, ai është njoftuar për rezultatin e pikëve për secilën procedurë ku ka konkurruar, si dhe për të drejtën e ankimit me shkrim pranë Komitetit të Pranimi për Ngritje në Detyrë dhe Komitetit të Përhershëm të Pranimi, për këtë rezultat.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, në lidhje me pretendimet e nëpunësit se ankesat e tij nuk janë trajtuar apo përgjigja që ka marrë nuk ka qenë bindëse, rezulton se ato nuk qëndrojnë. Kjo për faktin se nëpunësi nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit me shkrim, si pranë Komitetit të Pranimi për Ngritje në Detyrë, sipas përcaktimeve të pikës 35, Kreu III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, ashtu dhe në Komitetin e Përhershëm të Pranimi, sipas pikës 22, Kreu IV, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, për asnjë prej procedurave konkurruese, në të cilat ai ka marrë pjesë.

Gjithashtu, nëpunësi, në dokumentacionin bashkëngjitur kërkesës drejtuar Komisionerit, nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore, që të vërtetojë pretendimin se ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe se ankesat e tij nuk janë shqyrtuar apo përgjigja të mos ketë qenë bindëse.

Më tej, nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton që konkurrenti, ka nënshkruar deklaratën me shkrim se nuk ka dëshiruar që intervista me gojë të regjistrohet me zë, detyrim ky që rrjedh në zbatim të përcaktimeve në pikën 15, paragrafi II/2, të Kreut II, *Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive*, si dhe pikës 5, paragrafi V/6, të Kreut V, *Ngritja në detyrë*, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për*

plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme e të ulët drejtuese...” gjë e cila e bën të pamundur verifikimin e cilësisë së përgjigjeve të cilat mund të vinin në dyshim përfundimet e organizmave përkatëse.

Lidhur me pretendimin tjetër, se ai dhe specialistët e tjetrë të Zyrës Rajonale Statistike Tiranë, (*pozicioni i punës ku ai vazhdon të jetë i punësuar*), pa ndonjë shkak të njohur, kanë pësuar ulje të pagës në masën 10.000 lekë, konstatohet që kjo pagesë shtesë mbi pagën mujore për natyrë të veçantë pune, paguhej sipas pikës **4/14**, të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, është hequr për shkak të shfuqizimit të kësaj dispozite, nëpërmjet pikës “e”, të vendimit nr. 107, datë 06.03.2019, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatës së Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit”*”, të ndryshuar .

Në këto kushte, kur veprimet e Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND) dhe Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP), vlerësohen të kryera në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, si dhe heqja e pagesës për vështirësi pune, në masën 10.000 lekë, është kryer në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur, pretendimet e ngritura gjenden të pabazuara prandaj nuk ka vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimit administrativ për këtë çështje.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe nenin 16, pika 6, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së konkurrimit për ngritje në detyrë (Aplikim nr. 109), për pozicionin “*Përgjegjës-Spektori i Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor*”, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit”; dhe konkurremeve për lëvizje paralele, (Aplikimi nr. 111), pozicioni “*Përgjegjës – Zyra Rajonale Statistike Korçë, Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit*”; (Aplikimi nr.112), pozicioni “*Specialist – Spektori*

i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Mjedisit”, në Institutin e Statistikave.

2. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së veprimit administrativ të kryer, për heqjen e shtesës së pagesës të shumës 10000 lekë, për vështirësi në punë, për shkak se është veprim i ligjshëm, i kryer në bazë të Vendimit nr. 107, datë 06.03.2019, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës...etj.*
3. Arkivimin e çështjes së filluar në bazë të kërkesës së regjistruar me nr. 81 prot., datë 18.01.2021, paraqitur prej nëpunësit *****.
4. Të njoftohet për këtë vendim Instituti i Statistikave, si dhe punonjësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha